


MyChart është portali ynë i pacientëve në NYC Health + Hospitals që ju jep akses elektronik në të dhënat tuaja shëndetësore, 24/7. Ne e përdorim gjithashtu MyChart për të ofruar videovizita që të mund të merrni kujdes shëndetësor nga shtëpia. Për ndihmë me videovizitat e MyChart, telefononi në **linjën e ndihmës së MyChart** në nr. **1-844-920-1227** dhe **shtypni 1**.


Videovizitë me smartfonin/tabletën tuaj: Përdorni aplikacionin MyChart!

Nëse planifikoni të përdorni smartfonin/tabletën tuaj për vizitën me video, **duhet** të shkarkoni aplikacionin MyChart për të marrë pjesë në videovizitë. Për të hyrë në videovizitën tuaj me smartfon, ndiqni hapat e mëposhtëm:




1. Duke përdorur kamerën e smartfonit, skanoni kodin QR më poshtë për të shkarkuar **aplikacionin MyChart** falas:



2. Hapni aplikacionin dhe identifikohuni në llogarinë tuaj të **MyChart**.




3. Klikoni në ikonën **Visits** (Vizitat). Në vijim klikoni te **videovizita** dhe butoni **Begin Visit** (Fillo vizitën) për t'u futur në videovizitë.




Videovizitat e MyChart

4. Do të shfaqet një dritare që pyet nëse programi mund të "përdorë mikrofonin dhe kamerën tuaj". Zgjidhni **Allow** (Lejo). Kjo do të lidhë mikrofonin dhe kamerën e telefonit që ofruesi juaj të mund t'ju shohë dhe dëgjojë gjatë videovizitës.
5. Do të kaloni në një faqe mbërritëse ku duhet të shkruani emrin tuaj. Klikoni **Join Meeting** (Hyr në takim) për të kaluar në dhomën e pritjes. Mund ta kontrolloni **lidhjen e videos/zërit** në këtë faqe.
6. Ju do të hyni në një **dhomë pritjeje** ndërsa mjeku përfundon me pacientin e mëparshëm. Mjeku do të shohë që jeni në dhomën e pritjes virtuale dhe do t'ju bashkohet së shpejti!
7. **Pasi të ketë hyrë ofruesi juaj**, do të pranoheni në videovizitë.


4.




5.




6.



7.





Këshillë me rëndësi!

Ofruesi juaj mund t'ju dërgojë tani një **mesazh teksti** për të hyrë në videovizitë nëse nuk keni mundësi të përdorni MyChart! Thjesht **klikoni në lidhjen** në mesazhin e tekstit dhe do të hapet videovizita.


Videovizita duke përdorur kompjuterin tuaj: Përdorni një shfletues të mbështetur!

Për videovizitat e MyChart mbështeten shfletuesit e mëposhtëm:


- [Chrome](#)
- [Firefox](#)
- [Safari](#)

(SHËNIM: Internet Explorer NUK punon me vizitat me video)

1. Identifikohuni në llogarinë tuaj të **MyChart**, shkoni te menyja **Visits** (Vizita) dhe zgjidhni videovizitën tuaj nga lista e takimeve të ardhshme, klikoni **Details** (Detaje), më pas klikoni **Begin Video Visit** (Fillo videovizitën).



- Do të shfaqet një dritare që pyet nëse programi mund të "përdorë mikrofonin dhe kamerën tuaj". Zgjidhni **Allow** (Lejo). Kjo do të lidhë mikrofonin dhe kamerën e telefonit që ofruesi juaj të mund t'ju shohë dhe dëgjojë gjatë videovizitës.
- Shkruani emrin tuaj dhe klikoni **Join Meeting** (Hyr në takim).
- Ndërsa prisni, kontrolloni **lidhjen e videos/audios**.



- Për të provuar mikrofonin, klikoni në butonin e **mikrofonit**. Kështu mund të çaktivizoni zërin tuaj.
- Për të provuar **videon**, klikoni në butonin e kamerës për të fshehur ose aktivizuar/çaktivizuar videon. Kjo është një provë për t'u siguruar që videoja funksionon.
- Këtu mund të shikoni nëse e keni në rregull linjën e internetit.